



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.936 Prot.

Tiranë, më 10._08. 2023

V E N D I M

Nr. 160, Datë 10.08. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, mori në shqyrtim ankesën me Nr. 153 Regj, datë 03.08.2023, paraqitur nga Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (SPSHSH), përfaqësuar nga Kryetari z.G.S, në të cilën pretendohet diskriminimi i studentëve që ndjekin aktualisht studimet në Universitetin e Mjekësisë, të shkaktuar nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet miratimit të ligjit “*Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, SPSHSH parashtron si më poshtë:

“Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka miratuar në datë 21.07.2023 ligjin “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”. Duket që ky ligj ka për qëllim sigurimin e burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shtetërore në Republikën e Shqipërisë, duke synuar të përcaktojë rregulla specifike për trajtimin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë. Qëllimi i këtij ligji,

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

edhe pse është i një natyre sociale, cenon rëndë parimet bazë në fushën e arsimit dhe të punësimit në vend, të saksionuara dhe garantuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Ligji i mësipërm është antikushtetues, pasi cenon rëndë të drejtat themelore të njeriut të garantuara nga Kushtetuta dhe krijon premisa të qarta diskriminuese në fushën e arsimit të lartë dhe të punësimit. Punësimi në çdo sektorë të vendit nuk mund dhe nuk duhet të jetë mbi baza të pavullnetshme. Askush nuk mund të detyrohet të ushtrojë në mënyrë të pavullnetshme dhe mbi baza diskriminuese një profesion. Ligji që është objekt i kësaj kërkese, cenon dhe tejkalon kufijtë e garancive kushtetuese. Më konkretisht konstatojmë si më poshtë:

- 1- Ligji trajton në mënyrë të diferencuar e diskriminuese studentët e Universitetit të Mjekësisë Dega “Mjekësi e Përgjithshme” krahasuar me degët e tjera të po këtij Universiteti apo me degë të tjera të Universitetit të Tiranës dhe universiteteve të tjera në vend, duke e rënduar në mënyrë drastike dhe diskriminuese pozitën financiare të këtyre studentëve. Ky diskriminim vihet re në faktin që tarifa e studimit për studentët përlllogaritet me një metodologji të ndryshme nga fakultetet e tjera të po këtij Universiteti apo të Universitetit të Tiranës.*
- 2- Ligji (sipas nenit 6) trajton në mënyrë diskriminuese punësimin me prioritet pas përfundimit të Fakultetit të Mjekësisë krahasuar me ata që nuk pranojnë të bëhen pjesë e skemës apo që vijnë nga Universitetet jo publike. Duke trajtuar në mënyrë preferenciale një grup studentësh që pranojnë të punojnë në Shqipëri për 5 vitet e para pas diplomimit, ligji diskriminon kategoritë e tjera të cilët përfundojnë studimet për Degën “Mjekësi e Përgjithshme” po në të njëjtin fakultet apo fakultete të tjera jo publike, duke diskriminuar hapur në punësim studentët që zotërojnë të njëjtën diplomë.*
- 3- Ligji (në nenin 4, paragrafi 2 dhe 3) cenon të drejtat e fituara më parë nga studentët e Fakultetit të Mjekësisë, të cilët e kanë fituar tashmë fakultetin dhe ndodhen në vazhdim. Me fillimin e Fakultetit të Mjekësisë, studentët dhe fakulteti janë dakordësuar për një kosto të caktuar e një tarifë e cila përlllogaritet sipas një metodologjie të caktuar. Ndryshimi i përlllogaritjes së kësaj metodologjie e cila rrit në mënyrë të paarsyeshme kostot për studentët përbën shkelje të hapur të ligjit dhe një trajtim të hapur diskriminues.*
- 4- Edhe studentët që nuk mund ta pranojnë këtë trajtim me prioritet përsëri detyrohen të paguajnë një tarifë më të lartë, e cila është në kundërshtim me sigurinë juridike të palëve në një marrëdhënie kontraktore.*
- 5- Ligji cenon të drejtën e studentëve që kanë filluar studimet dhe atyre që janë në prag të diplomimit të tyre në fakultetin e Mjekësisë, për pajisjen me dokumentin përkatës të diplomimit në përfundimin e plotë të studimeve të tyre, në shkelje të plotë të marrëveshjes që kanë lidhur/nënshkruar në fillim të studimeve. Në një mënyrë të padrejtë dhe diskriminuese studenti që përfundon studimet e plota në degën përkatëse, në vend të pajisjes me dokumentin e diplomimit i ofrohet marrëveshja e “njëanshme e pavullnetshme” që të punojë në Shqipëri për të paktën 5 vitet në vazhdim. Sipas këtij ligji, dokumenti i diplomimit nuk do të lëshohet nga Fakulteti i Mjekësisë, derisa të përmbushet afati përkatës, që mund të konsiderohet si një punësim i pavullnetshëm.*
- 6- Ligji (në nenin 4, paragrafi 1/c) përcakton se, diploma e studentit të sapa diplomuar nuk i jepet titullarit të kësaj të drejte, por institucionit ku ai do të punësohet. Kjo është e padrejtë,*

diskriminuese dhe në shkelje të hapur të të drejtave themelore të çdo të diplomuari që pas përfundimit të të gjitha detyrimeve akademike), të pajiset me dokumentat përkatëse dhe të jetë zotëruesi i vetëm i këtyre dokumentave.

- 7- *Miratimi në Kuvend i këtij ligji me procedurë të përshpejtuar pa u konsultuar gjerësisht me grupet e interesit, tregon për një mosrespektim të të drejtës bazë të atyre që iu drejtohet dhe që mbi ata do të rëndojë nesër aplikimi/zbatimi i tij. Një ligj me efekte kaq të forta ekonomike, sociale dhe juridike duhet të ishte objekt i një diskutimi të gjerë publik.*
- 8- *Efektet prapavepruese të këtij ligji, për studentët të cilët kanë filluar të ndjekin studimet e tyre në degën përkatëse dhe që nuk kanë qenë në dijeni në krye të herës për kushtet shitesë të pajisjes së tyre me diplomën përkatëse, janë në shkelje të hapur të sigurisë juridike në fushën e arsimit, duke krijuar një rrethanë diskriminuese ndërmjet studentëve të tyre që ndjekin të njëjtën degë/program studimi në institucionin e arsimit të lartë jo publik.*

Të gjitha argumentet e mësipërme krijojnë premisa të qarta për vendosjen e studentëve në rrethana të rënda diskriminuese, duke cenuar ushtrimin e një profesioni, sikundër çdo profesioni tjetër mbi bazat e një vullneti të lirë.”

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri, pranimin e ankesës dhe konstatimin e diskriminimit të studentëve që ndjekin aktualisht studimet në Universitetin e Mjekësisë, të shkaktuar nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet miratimit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të ligjit “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “b”, të LMD, ku parashikohet: “1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;”

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’ a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të çenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar*

të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”.

Nga aktet e administruara rezulton se, pala ankuese SPSHSH, është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 42717, datë 14.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur, SPSHSH nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e studentëve që ndjekin aktualisht studimet në Universitetin e Mjekësisë, të shkaktuar nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet miratimit të ligjit *“Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”*. Bazuar në vendimin e regjistrimit të gjykatës, SPSHSH, është një bashkim vullnetar i profesionistëve të shërbimit shëndetësor që ka për qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave ekonomike, sociale e profesionale të anëtarëve të saj.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë sindikale ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se pala ankuese legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Ligji nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në nenin 1 të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur dhe pretendimet e ngritura nga pala ankuese, Komisioneri vlerëson se:

Pala ankuese në ankesën objekt shqyrtimi, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të studentëve që ndjekin aktualisht studimet në Universitetin e Mjekësisë, të shkaktuar nëpërmjet miratimit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të ligjit “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, me pretendimin se ky ligj vjen në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pasi cenon rëndë të drejtat themelore të njeriut të garantuara nga Kushtetuta dhe krijon premisa të qarta diskriminuese në fushën e arsimit të lartë dhe punësimit.

Përpara se Komisioneri të vijojë me arsyetimin në lidhje me ankesën objekt shqyrtimi, dëshiron të evidentojë faktin se, ligji “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, i cili është objekt i ankesës së paraqitur nga pala ankuese, në momentin e paraqitjes së kësaj ankese, nuk rezulton të jetë një akt me fuqi juridike.

Referuar procedurës së miratimit dhe hyrjes në fuqi të një ligji dhe bazuar në nenin 84, të Kushtetutës, ligji pas miratimit nga Kuvendi, duhet të dekretohet nga Presidenti i Republikës dhe hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare. Ligji i cili është bërë objekt ankimi pranë Komisionerit, është një akt i cili nuk rezulton që të ketë hyrë ende në fuqi, sipas procedurës së parashikuar në Kushtetutë.

Megjithatë, duke ju rikthyer shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, edhe nëse ligji i cili është bërë objekt ankimi pranë Komisionerit do të kishte hyrë në fuqi dhe do të ishte një akt me fuqi juridike, ankesa e paraqitur nga pala ankuese nuk mund të pranohet për shqyrtim të mëtejshëm nga Komisioneri, pasi objekti dhe kërkimi i saj nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit.

Parimi i shtetit të së drejtës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas të drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore (*shih Vendimin nr. 15, datë 15.04.2010, vendimin nr.22, datë 24.04.2015, vendimin nr. 2 datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007, nr. 11, datë 02.04.2008, vendimi nr. 25, datë 05.12.2008*).

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese është autoriteti i vetëm që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. (Neni 124, i Kushtetutës). Në referim të nenit

131, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, është institucioni i cili vendos në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është një institucion i ngarkuar nga ligji për të siguruar mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. (neni 21, i LMD) Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit (neni 22, i LMD), ndërsa kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashikohen nga neni 32, i LMD.

Në këtë mënyrë, baza dhe kufiri në ushtrimin e kompetencave për Komisionerin, janë Kushtetuta dhe ligjet në fuqi. Komisioneri ka kompetencë që të shqyrojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar; të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes legjitim, qoftë kur ato pretendojnë diskriminim në emër të një individi ose grupeve të individëve, ashtu edhe kur pretendojnë diskriminim që lidhet me interesa kolektive; të kryejë hetime kryesisht pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; por në çdo rast, ushtrimi i këtyre kompetencave bëhet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Një ligj i cili vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, është një ligj i cili nuk është në përputhje me Kushtetutën, por gjykimin dhe vlerësimin për një gjë të tillë mund ta bëjë vetëm Gjykata Kushtetuese, si i vetmi autoritet i autorizuar nga Kushtetuta për të vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, marrja në shqyrtim e një pretendimi për antikushtetueshmëri të një ligji me Kushtetutën apo vlerësimi nëse një ligj është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një kompetencë që Kushtetuta i'a ka njohur vetëm Gjykatës Kushtetuese dhe se asnjë institucion tjetër shtetëror, përfshi edhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili nuk mund të marrë në shqyrtim një çështje, për të cilën nuk ka kompetencë dhe kur shqyrtimi i kësaj çështje është në kompetencën e një tjetër institucioni.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa "b", të Ligjit nr.10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, ku përcaktohet se: "4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji." Komisioneri arrin në përfundimin se, nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, germa "b", të ligjit nr. 10 221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*" dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet për t'iu nënshtuar shqyrtimit të mëtejshëm.

Në bazë të nenit 134, pika 1, germa "h" dhe pika 2, parashikohet: "*1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: h) organizatave; 2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët "d", "dh", "e", "ë", "f", "g", "gj", "h" dhe "i", të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre*".

Pala ankuese, SPSHSH, si një organizatë, e cila është një bashkim vullnetar i profesionistëve të shërbimit shëndetësor që ka për qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave ekonomike, sociale e profesionale të anëtarëve të saj, në bazë të dispozitave të mësipërme kushtetuese mund

t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për të vlerësuar dhe vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit në fjalë me Kushtetutën

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b” dhe nenin 33, pika 4, gërma “b”, të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me Nr. 153 Regjistri, datë 03.08.2023, të paraqitur Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (SPSHSH), pasi nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, sipas Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Fusha: Arsim/Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim